

Raport i auditimi funksional i Organeve të OSK-së per vitin 2025

Hyrje

Bazuar ne Specifikimet teknike të paraqitura ne dosjen e tenderit se OSK-së përveq dhenies së Opinionit për Pasqyrat fianciare 2025 të Odës së Stomatologeve të Kosovës (OSK) konform Standardeve Nderkombetare të Auditimit (SNA) , kemi marrë përgjegjësinë të kryejmë auditimin funksional të Organeve të OSK-së e cila njeherit është pjesë përberëse e Raportit të Auditorit .

Ne këtë Raport do të prezentojm performancën dhe gjetjet eventuale të cilat nuk vlersohen si materiale por me shumë janë si mosrespektim i parimeve dhe rregulloreve ne disa raste

Ne vijim ju prezentojmë gjetjet lidhur pasqyart financiare 2025 si dhe vlersimet tona lidhur me punen e organeve të OSK-së për këtë periudhë.

1). Performanca e organeve të OSK-së per vitin 2025

Sipas kërkeses së Odës dhe duke u bazuar ne Ligjin Nr.04/L-150 për Odat Profesionale Shëndetësore , Statutin e OSK-së ne kemi marrë persipër që të auditojmë performancen e organeve të OSK-së për periudhen 2025.

Bazuar ne Raportin vjetor 2025 të Odës verejtëm se janë kryer shumë aktivitete konformë përgjegjësiave dhe kompetencave të cilat kishim i veçuar si me poshtë :

1 . Projekt buxhet për vitin i cili u shqyrtua dhe u miratua per te Hyrat dhe Shpenzimet

a) Të hyrat nga Anëtarësia, Licencimi dhe rilicencimi ,EVP , Faksimilat, Vërtetimet e Kodit ,Etik,Hulumtimet biomjekësore

b) Shpenzimet kryesore : Shpenzimet administrative , Pagat dhe mëditjet , Kontributet pensionale, Tatimi në paga dhe qira , Botimi i revistës stomatologjike etj,

2. Plani i Punës 2026 , U miratua plani i punës që përfshin:

- Vazhdimësinë e transparencës dhe llogaridhënies
- Publikimin dhe azhurnimin e listës së anëtarësisë dhe regjistrin të licencave
- Analizimin e akteve normative për ndryshim/plotësim
- Sigurimin e stabilitetit financiar
- Fuqizimin e platformës digjitale
- Edukimin e Vazhdueshëm Profesional
- Organizimin e Konferencës vjetore “Trendet e Reja në Stomatologji”

3. Ndryshime dhe plotësime rregullative

a) Ndryshimi i Vendimit nr. 2036 (02.11.2021) per taksat administrative për evente:

- 300€ për kongrese, konferenca, simpoziume
- 200€ për trajnime, kurse, ligjërata
- 10% e kuotizimit për çdo certificate

b) Ndryshim në Kodin e Etikës ku ndalohej kategorikisht publikimi dhe reklamimi i çmimeve nga stomatologët për përfitim (riformulim i nenit 68).

c) Plotësim i Rregullores nr.152 (24.02.2025) , Rreth afatit për iniciimin e procedurës disiplinore: 1 vit nga data e shkeljes.

d) Ndryshim në Rregulloren për Solidaritet , ku me rastin e pensionimit, anëtari përfiton 200€, mirpoNuk përfitojnë ata që nuk kanë përmbushur obligimet financiare.

2. Zbatueshmëria e akteve normative për vitin 2025 nga ana e organeve të OSK-së

a) Vlerësimi i punës së Organeve të OSK-së

Kuvendi si organi më i lartë i OSK-së dhe Kryetari i OSK-së si organ ekzekutiv duke u bazuar në përgjegjësitë e tij që dalin nga nenet 20 dhe 23 të Statutit të OSK-së dhe neni 9 i Rregullores për procedurën vendimtare të OSK-së, kanë kryer funksionin me kompetencë.

Këshilli Drejtues (KD), bazuar në procesverbalet e KD konstatuar se KD gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 9 takime ku janë marrë vendime të rëndësishme. Nga verifikimi I deshmive për këto aktivitete nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi për punën e tij. Këshillit mbikqyrës gjatë kësaj periudhe ka kryer aktivitetet e tij konform neni 29 pika 1.1 për mbikqyrjen e afarizmit financiar të Odës.

Këshilli Etik dhe Gjyqi i Nderit dhe Prokurori i Odës, bazuar në raportet e Komisionit për çështje etike dhe deshmimet tjera të verifikuara e vlerësojmë se në përgjithësi janë zbatuar kompetencat që dalin nga nenet 31, 34 dhe 35 të Statutit të OSK-së.

b) Vlerësimi i punës së Komisioneve të OSK-së

Komisionet e përhershme, bazuar në nenin 37 të OSK-së ka të themeluar 6 Komisione të përhershme dhe fushveprimtaria e tyre është e percaktuar me Rregulloren të mbrendshme të miratuar nga Kuvendi i Odës.

- ❖ Nga raportet e **Komisionit për Licencim** , Rilicencim dhe Antarësim shihet se gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar dhe aprovuar 201 lëndë per Licencim , 125 per Licencim Specialistik ,144 per Rilicencim të përgjithshëm dhe 96 per Rilicencim Specialistik , derisa janë aprovuar 160 kërkesa të reja për anëtarësim.
- ❖ **Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm profesional (EVP)** për këtë periudhë bazuar në raportet e tij ka mbajtur simpozume dhe puntori për anteret e OSK-së ,të cilat aktivitete janë organizuar konformë Rregullores të OSK-së.
- ❖ **Komisioni për çështje Etike** ka mbajtur 4 takime gjatë ku janë aprovuar 5 kërkesa për punime shkencore në lëminë e Stomatologjisë. Derisa sipas raportit të komisionit për Solidaritet dhe ndihmë reciproke në vitin 2025 nuk ka pranuar asnjë kërkesë.
- ❖ **Komisioni për buxhet dhe financa** edhe në vitin 2025 ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet periodike e vjetore financiare si dhe projektin e buxhetit të OSK-së. Departamenti i financave dhe kontabilitetit të OSK-së ka mirëmbajtur dhe avansuar evidencat kontabël duke azhurar listat e anëtarëve të OSK-së si bazë për të hyart e Odës duke finalizuar me Pasqyrat vjetore financiare Janar-Dhjetor 2025.
- ❖ Krahasuar pozicionet e Pasqyrave financiare e vitit 2025 me ato 2024 shohim se ka një zvogëlim të hyrave rreth 5% dhe anën tjetër kemi një rritje të shpenzimeve me rreth 18 % në raport me vitin paraprak.

Bazuar nga verifikimi I deshmive mund të konstatojmë se shpenzimet e buxhetit janë ekzekutuar në harmoni me Rregulloren e OSK-së për menaxhimin e financave .

Letrën e punoi :

Haxhi Nimanaj , auditor ligjor

